



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



LISTA E VENDIMEVE TE MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAIL LATIFI

NGA DATA 21 DERI 25 GUSHT 2023

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-2031-2023
2	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-2032-2023
3	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-2033-2023
4	Vendim për lejin e pagesës për punë jashtë orarit të punës	NRP-02-2034-2023
5	Vendim për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së palujatshme të Komunës	NRP-02-2035-2023
6	Vendim për lejin e pageses për punë jashtë orarit të punës	NRP-02-2036-2023
7	Vendim miratohet kërka [REDACTED] eci	NRP-02-2043-2023
8	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të mobilitetit urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027	NRP-02-2047-2023
9	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën e Rahovecit	NRP-02-2048-2023
10	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Rahovecit 2022-2027	NRP-02-2049-2023
11	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit 2022-2026	NRP-02-2050-2023
12	Vendim për caktimin e komisionit për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare-jokapitale	NRP-02-2051-2023
13	Vendim për caktimin e komisionit për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare-jokapitale	NRP-02-2052-2023

25.8.2023, Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIK OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2054 Nr. i faq/Br.str/No.pg 8
Data/Datum/Date 28 / 8 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine –



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2031 Nr. i faq./Br.str./No.pg 5

Data/Datum/Date 22 / 8 / 2023

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin:** “Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, parqet, varrezat në Komunën e Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-23-8000-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-056-5-2-1, të datës: 21.8.2023, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Artan Asllani, anëtar,
 - 1.3. Meriton Gashi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, parqet, varrezat në Komunën e Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-23-8000-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-056-5-2-1, të datës: 21.8.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2032 Nr. ifaq/Br.str./No.eg 5
Data/Datum/Date 22 / 8 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes së Rahovecit: Dejnë, Krushë e Madhe, Gradish, Drenoc, Rahovec (shtegu të zhdrella, shtegu të maja e shkodranit) dhe pastrimi i lumit Biqec në Ratkoc" me numër të kontratës: 623-23-6674-2-2-1/C494, si në vijim:
 - 1.1. Izet Morina, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i lartë për Buxhet dhe Financa, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Erhan Morina, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i kontratës,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ





Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:


V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i parqeve në Oterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec”, me Nr. prokurimi: 623-23-7507-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-053-5-2-1 të datës: 22.8.2023, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i parqeve në Oterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektorit për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec”, me Nr. prokurimi: 623-23-7507-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-053-5-2-1 të datës: 22.8.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë, Nr.03/L-147 të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për **Ajet Sahitaj**, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**, Drejtoria për Administratë, në Komunën Rahovec.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë jashtë orarit të punës është **30 (tridhjetë euro)** për kryerjen e punës, respektivisht, kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës Rahovec**, i cili më datë **8.8.2023**, në ceremoninë e martesës, ka kryer lidhjen e kurorëzimit të çiftit **Dionis Morina dhe Edona Desku**.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi: Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me kërkesën e **Ajet Sahitaj**, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën Rahovec dhe me autorizimin e drejtorit për Administratë, të datës 7.8.2023, punëtori i lartcekur ka marrë pjesë më **8.8.2023**, në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës, jashtë objektit të Komunës Rahovec, prandaj për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës Rahovec dhe jashtë orarit të punës**, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me vendim të njoftohen :

- **Ajet Sahitaj**, zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**,
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**,
- **Zyra e Personelit, dhe**
- **Arkivi.**

 SHTETI I KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL COUNCIL

Njësia Nr./Br./No. 12/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No. 2034 Nr. i faq./Br. str./No. pë. 6
Data/Datum/Dato 23/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC





Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 Statutit të Komunës Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës Rahovec 01 Nr. 597 të datës 16.02.2018 për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjithë komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës Rahovec, Vendimit të Kuvendit të Komunës Rahovec 01 Nr. 2055/22 të datës 28.12.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M


Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të formuar me vendim të Kuvendit të Komunës Rahovec 01 Nr. 2055/22 të datës 28.12.2022, si në vijim:

1.1. Besmire Bytyçi	2 x 30€ = 60€ (gjashtëdhjetë euro);
1.2. Albtor Mullabazi	2 x 30€ = 60€ (gjashtëdhjetë euro);
1.3. Rumir Zhuniqi	2 x 30€ = 60€ (gjashtëdhjetë euro);
1.4. Armir Vuçitërna	2 x 30€ = 60€ (gjashtëdhjetë euro).
2. Të lartpërmendurve në pikën 1 të këtij vendimi, u lejohet pagesa e mëditjeve pasi kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
3. Të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës Rahovec 01 Nr. 597 të datës 16.02.2018 për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës Rahovec.
4. Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi buxhetor: Paga dhe Mëditje.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të lartpërmendurve në pikën 1,
- Njësisë së Personelit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë Nr.03/L-147 të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR PUNË JASHTË ORARIT TË PUNËS

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për **Ajet Sahitaj**, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**, Drejtoria për Administratë, në Komunën Rahovec.
2. Vlera e pagesës për punë shtesë **jashtë orarit të punës** është **30 euro (tridhjetë)** për kryerjen e punës, respektivisht, kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës Rahovec**, i cili më datës **16.8.2023**, në ceremoninë e martesës, ka kryer lidhjen e kurorëzimit të çiftit **Nexhat Sylejmanaj dhe Samire Hoti**.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga Kodi: Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me kërkesën e **Ajet Sahitaj**, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën Rahovec dhe me autorizimin e drejtorit për Administratë, të datës 16.8.2023, punëtori i lartcekur ka marrë pjesë më **16.8.2023**, në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës, jashtë objektit të Komunës Rahovec, prandaj për shkak të kryerjes së punës - lidhjes së kurorëzimit **jashtë objektit të Komunës Rahovec dhe jashtë orarit të punës**, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për kryerjen e punës.

Me vendim të njoftohen :

- **Ajet Sahitaj**, zyrtar i gjendjes civile në **Çifllak**,
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**,
- **Zyra e Personelit, dhe**
- **Arkivi**.

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I ARRIET TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENKA OPŠTINE ORAHOVAC
Njësia Nr./Br./No <u>02/Kabineti i Kryetarit</u>	
Nr./Br./No <u>2036</u> Nr. i faq./Br./str./No.pg <u>6</u>	
Data/Datum/Date <u>23/8/23</u>	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Amra Kollari** nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-003707/23, e dt. 21.08.2023 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katerqind euro) për [redacted] [redacted] (Shërbes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj.Amra Kollari nga Rahoveci me datë 21.08.2023 ka parashtuar kërkesë për ndihmë financiare për [redacted] [redacted] datë 22.07.2023 ka lindur djal në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për [redacted] [redacted] të kësaj lloji dhe numri [redacted] shërbesve elementare [redacted].

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.Amra Kollari** nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Nr. [redacted] / No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr. 20h3 / Nr. i faq/Br.str/No.pg 7

Datim/Date 2h 8/23





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Planit të mobilitetit urban për Komunën Rahovec 2022-2027, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të mobilitetit urban për Komunën Rahovec 2022-2027

1. Sylejman Daka, i sistemuar në vendin e punës: zyrtar për shërbime publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën Rahovec, **CAKTOHET:**

1.1 Zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të mobilitetit urban për Komunën Rahovec 2022-2027

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të mobilitetit urban janë të përcaktuara në Planin e mobilitetit urban për Komunën Rahovec 2022-2027, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 01 Nr. 406/22, i datës 28.12.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 01 Nr. 20/23, i datës 28.2.2023.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të hartojë raport me shkrim në baza 6 (gjashtë) - mujore për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike mbi ecurinë e zbatimit të Planit të mobilitetit urban për Komunën Rahovec 2022-2027.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Sylejman Dakës,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
- Arkivit.

	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC		
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 2013 Nr. i faq./Br.su./No.pg 4		
Data/Datum/Date 26/8/23		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVËS
Kryetari i Komunës
Sylejman Daka
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën Rahovec, Kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën Rahovec

1. Beqir Hamza, i sistemuar në vendin e punës: zyrtar për emergjencë, në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën Rahovec, **CAKTOHET:**

1.1 Zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën Rahovec.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës janë të përcaktuara në Planin e vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën Rahovec, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 01 Nr. 404/22, i datës 28.12.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin, me Nr. Prot. 01 Nr. 21/23, i datës 28.2.2023.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të hartojë raport me shkrim në baza 6 (gjashtë) - mujore për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim mbi ecurinë e zbatimit të Planit të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për Komunën Rahovec.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Beqir Hamzës,
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe
- Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDNIKA OPŠTINE / KABINET MUNICIPAL MAYOR

Njësi Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 2048 Nr. i faq./Bastir/No pg 7

Data/Datum/Date 26 / 8 / 23

KABINETI / KABINET / KABINET





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Planit të transportit rrugor lokal në Komunën Rahovec 2022-2027, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të transportit rrugor lokal në Komunën Rahovec 2022-2027


1. Fadil Bugari, i sistemuar në vendin e punës: referent për shërbime publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën Rahovec, **CAKTOHET:**

1.1. Zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të transportit rrugor lokal në Komunën Rahovec 2022-2027.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës janë të përcaktuara në Planin e transportit rrugor lokal në Komunën Rahovec 2022-2027, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 01 Nr. 405/22, i datës 28.12.2022.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të hartojë raport me shkrim në baza 6 (gjashtë) - mujore për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike mbi ecurinë e zbatimit të Planit të transportit rrugor lokal në Komunën Rahovec 2022-2027.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Fadil Bugarit,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit 2022-2026, kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Rahovec 2022-2026

1. Bjondina Ramaj, e sistemuar në vendin e punës: zyrtare e lartë për mbrojtje të mjedisit, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën Rahovec, **CAKTOHET:**

1.1. Zyrtare përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Rahovec 2022-2026.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës janë të përcaktuara në Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Rahovec 2022-2026, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës Rahovec, me Nr. Prot. 01 Nr. 372/22, i datës 23.9.2022.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të hartojë raport me shkrim në baza 6 (gjashtë) - mujore për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike mbi ecurinë e zbatimit të Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Rahovec 2022-2026.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Bjondina Ramajt,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
- Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2050 Nr. i faq./Br.str./No.pg 7
Data/Datum/Date 24.8.23
RAHOVEC / ORAHOVAC





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Preşednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare - jopakitale

1. Caktohet komisioni për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare - jopakitale në Komunën Rahovec, në përbërje prej:
 - 1.1. Tefik Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Bekim Krasniqi, anëtar,
 - 1.3. Luan Sharku, anëtar.
2. Komisioni për tjetërsimin e pasurisë jofinanciare - jopakitale në Komunën Rahovec do të jetë organ i përkohshëm, i formuar nga kryetari i Komunës.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
3. Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSJEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE

Njësitë Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit i Komunës

Nr./Br./No 2051 Nr. i faq./Br.str./No pg 7

Data/Datum/Date 25/8/13

RAHOVEC / ORAHOVAC

Small Latif
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECI
KRYETARI I KOMUNËS



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovec / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për asgjësimin e pasurisë jofinanciare - jokapitale

1. Caktohet komisioni për asgjësimin e pasurisë jofinanciare - jokapitale në Komunën Rahovec, në përbërje prej:
 - 1.1. Luan Sharku, kryesues.
 - 1.2. Samir Hasku, anëtar.
 - 1.3. Tefik Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni për asgjësimin e pasurisë jofinanciare - jokapitale në Komunën Rahovec do të jetë organ i përkohshëm, i formuar nga kryetari i Komunës.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
3. Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE

Njësi Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit

Nr./Br./No 252 Nr. i fag/Br./No pg 7

Data/Date/Date 25.8.19

